

PLAN VEPRIMI PER ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE (NJËSIA IPA - KDIMDP)

Nr Rek	Rekomandimet	Renditja sipas nivelit	Referenca e paragrafit Në Raport	Reagimi i menaxhimit të subjektit të audituar	Afati i përcaktuar	Personat përgjegjës për realizimin e rekomandimeve
I	Për përmirësime ligjore					
1	Të adresohet përmirësimi ligjor për vendosjen e kriterëve të kualifikimit në caktimin e punonjësve të Njesisë IPA.	I Mesëm	Pika IV/2.1 Faqe 6	Adresimi i këtij rekomandimi është kompetencë e Drejtorisë së Financimeve dhe Kontraktimeve të Fondeve të BE-së, Bankës Botërore, dhe donatorëve të tjerë (CFCU) në përputhje me parashikimet e VKM nr.23 datë 12.01.2011 dhe VKM nr. 456 datë 05.09.2007, i ndryshuar. Për këtë arsye, në raportimin e rradhës pranë, Njësia IPA e Zyrës së Komisionerit do ta adresojë këtë gjetje.	Menjëherë	Drejtuesja Njesisë IPA
II.	Për përmirësimin e sistemeve					
1	Procesi i vlerësimit periodik të performancës në kryerjen e detyrave të specialistëve të Njesisë IPA të shoqërohet dhe me opinionin e drejtuesit të Njesisë IPA.	I Mesëm	Pika IV/2.1 Faqe 6	Me Vendimin nr. 84 datë 23.12.2020 të Kuvendit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës, dhe klasifikimit të pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, struktura e Zyrës së Komisionerit ka pësuar ndryshime. Në këtë kuadër, në përfundim të	Menjëherë e në vazhdim	Drejtuesja e Njesisë IPA; Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës.

				procesit të ristrukturimit, me hartimin e përshkrimeve të reja të punës, do të parashikohen edhe detyrat specifike në kuadër të programit IPA II për anëtarët e Njesisë		
III. Për masa organizative						
1	Të përfshihet në regjistrin e riskut mungesa e trajnimeve të stafit.	I Mesëm	Pika IV/2.2 Faqe 7	Ky rekomandim është zbatuar menjëherë nga Njësia IPA, dhe është përfshirë në Regjistrin e Riskut.	Menjëherë	Drejtuesja Njesisë IPA
2	Të bashkëpunohet me ASPA dhe institucionet e tjera që ofrojnë trajnime për rritjen e kapaciteteve të stafit në implementimin e projekteve të BE.	I Mesëm	Pika IV/2.2 Faqe 7	Për vitin 2021, nëpunësit civilë të Zyrës së Komisionerit kanë përgatitur individualisht kërkesat për trajnim pranë ASPA. Anëtarët e njesisë IPA kanë kërkuar trajnime specifike në kuadër të menaxhimit të programeve IPA.	Menjëherë e në vazhdim	Drejtuesja e Njesisë IPA. Drejtorja e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës